



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 259, Datë 21.10.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“PROSOL” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.10.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2609/1 prot., datë 16.10.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve *“Mbi kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”*,

Konstatohet se:

- Shoqëria “PROSOL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2609 prot., datë 10.10.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 21 MW, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas Aneksit A.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave a, b dhe c.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmës a.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave b, c, e, d, e dhe f.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria ka depozituar Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 92, datë 12.02.2025 “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “PROSOL” sh.p.k.”
- Shoqëria ka depozituar kontratën nr. 1353 rep., nr. 578 kol., datë 18.03.2025 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 21 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “PROSOL” sh.p.k.”, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, shoqërisë “PROSOL” sh.p.k.
- Shoqëria ka depozituar “Marrëveshjen për Lidhjen me Rrjetin e Transmetimit të Parkut Fotovoltaike Prosol Solar, të datës 26.06.2025, të nënshkruar mes OST sh.a. dhe shoqërisë “PROSOL” sh.p.k..
- Vendimin për VNM Paraprake, datë 19.07.2024, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për personin juridik “PROSOL” sh.p.k., për të zhvilluar projektin: “Ndërtimi i Centralit Fotovoltaike Prosol Solar, 21 MW”, dhënë për kapacitetin 21 MWp.
- Në lidhje me këtë aplikim, vlerësojmë se duhet të sqarohet me shoqërinë duke zhvilluar dhe një seancë dëgjimore, se si është ndjekur nga ana e saj, në paraqitjen e aplikimeve për marrjen e lejeve apo miratimeve përkatëse nga organet e tjera (si miratimi i OST sh.a. për pikën e lidhjes dhe Vendimi për VNM Paraprake lëshuar nga AKM), zbatimin i detyrimit të përcaktuar në kontratën e nënshkruar me MIE-n, në lidhje me kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaike.

Po ashtu, në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- Shoqëria duhet të depozitojë aktin përkatës të përfaqësimit në lidhje me përfaqësuesin ligjor të përcaktuar nga ana e saj në zbatim të shtojcës 1. (**gërma “d”**)

Pika 1.3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës financiar në mbështetje të realizimit të projektit, pasi nuk është depozituar asnjë dokument. (**gërma “b”**)
- Shoqëria duhet të ridepozitojë në ERE planin e biznesit, duke bërë parashikimet dhe përcaktimet përkatës për 30 vjet, sa afati i vlefshmërisë së licencës, dhe për kapacitetin 21 MW, sikurse miratuar në kontratën me MIE. (**gërma “c”**)

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- Formatin e plotësuar me të dhënat teknike në zbatim të Shtojcës 2. (**gërma “a”**)
- Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse përsa i përket njësive gjeneruese dhe kapacitetit të secilës, duke iu referuar kapacitetit total të përcaktuar në kontratën me MIE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 21 MW, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “PROSOL” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI